



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) NR.07/2024
PËR ORGANIZIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E SHTËPIVE PËR
MBROJTJEN E FËMIJËS¹

¹ Rregullore (QRK) Nr. 07/2024 për Organizimin dhe Fushëveprimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës, është miratuar në mbledhjen e 191-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 02/191, të datës 05.03.2024

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 30 paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (GZ. nr. 14, datë 17 Korrik 2019) si dhe nenit 19, paragrafit 6.2 i Rregullores së Punës të Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, datë 12 shtator 2011).

Mirton:

RREGULLORE (QRK) NR. 07/2024 PËR ORGANIZIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E SHTËPIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i organizimit dhe fushëveprimit të Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: Shtëpitë).

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Shtëpitë dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 3 Parimet

1. Të gjitha veprimet, masat dhe vendimet që ndërmerren në Shtëpitë udhëhiqen nga parimet e:

- 1.1. qasjes miqësore;
- 1.2. reagimit urgjent;
- 1.3. veprimit ndërdisiplinore ;
- 1.4. koordinimit ndërmjet institucioneve dhe akterëve të institucional të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e rastit në afat sa më të shkurtë kohor.

KAPITULLI II

KONCEPTI I PUNËS SË SHTËPIVE DHE LLOJET E SHËRBIMEVE

Neni 4

Koncepti i punës

1. Shtëpitë funksionojnë dhe zbatojnë këto koncepte dhe parime të punës:

1.1. ofrimin e të gjitha shërbimeve mbrojtëse ndaj fëmijës nën një “kulm” përgjatë 24 orëve dhe shtatë (7) ditë në javë;

1.2. zbatimin e drejtësisë miqësore, përfshirë respektimin e të së drejtës së fëmijës për pjesëmarrje, duke u siguruar që fëmija të dëgjohet dhe të marrë informacionin dhe mbështetjen e duhur për t'i ushtruar këto të drejta;

1.3. reagimin urgjent nëpërmjet veprimeve dhe vendimeve të cilat duhet të merren dhe zbatohen pa vonesa të paarsyeshme në mënyrë që të shmanget ndonjë dëm i riparueshëm. Të gjithë profesionistët për mbrojtjen e fëmijës duhet t'i japin prioritet rasteve ku jeta dhe interesi i fëmijës rrezikohet.

1.4. bashkëpunimin multidisiplinor dhe ndërinstitutional gjatë hetimit, procedurës, diagnostikimit, vlerësimit të nevojave dhe ofrimit të shërbimeve me qëllim që të shmanget traumatizimi i mëtejshëm dhe të arrihen rezultate në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës;

1.5. shërbime gjithëpërfshirëse dhe të arritshme që përmbushin nevojat themelore dhe specifike të fëmijës dhe të prindit apo kujdestarit të tij/saj;

1.6. garantimin e standardeve më të larta profesionale;

1.7. sigurimin e mbrojtjes dhe shërbimeve të nevojshme të cilat realizohen në mënyrë profesionale brenda afatit të paraparë ligjor.

Neni 5

Llojet e shërbimeve

1. Shtëpitë ofrojnë këto lloje të shërbimeve:

1.1. shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tre (3) ditë;

1.2. shërbime për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar;

1.3. shërbime këshilluese, veçanërisht terapi të ndryshme;

1.4.shërbime të strehimit të përkohshëm të fëmijës, i cili nuk ka mundësi të kthehet në shtëpi, nuk mund të strehohet në strehim familjar, apo është në shtëpi por kërkohet largimi i tij për shkak të rrezikut që i kanoset jetës apo shëndetit të tij.

KAPITULLI III THEMELIMI DHE ORGANIZIMI I SHTËPIVE

Neni 6 Themelimi i Shtëpive

1.Në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale, Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) themelon Shtëpitë pranë Qendrave për Punë Sociale, aty ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore.

2.Shtëpia në Komunën e Prishtinës vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Gllogovcit dhe të Graçanicës.

3.Shtëpia në Komunën e Gjilanit vepron për territorin Komunës së Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Klllokotit dhe Vërbocit.

4.Shtëpia në Komunën e Prizrenit vepron për territorin e Komunës së Dragashit, Suharekës dhe Mamushës.

5.Shtëpia në Komunën e Gjakovës vepron për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit.

6.Shtëpia në Komunën e Pejës vepron për territorin e Komunës së Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës.

7.Shtëpia në Komunën e Ferizajit vepron për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpcës dhe Hanit të Elezit; dhe

8.Shtëpia në Komunën e Mitrovicës vepron për territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.

9. Shtëpitë financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe donatorët.

10. Ministria përmes Ministrisë përkatëse për Financa, propozon në komisionin e granteve sigurimin e buxhetit për ndërtimin dhe funksionalizimin e Shtëpive.

11.Komuna në të cilën themelohet Shtëpia është përgjegjëse për sigurimin e parcelës dhe ndërtimin e objektit dhe infrastrukturës përcjellëse.

12.Ministria është përgjegjëse për sigurimin dhe rekrutimin e stafit profesional dhe menaxherial të Shtëpive.

Neni 7 Organizimi brenda Shtëpive

1.Shtëpitë organizohen në dhoma të cilat janë të specializuara për të ofruar shërbime sipas parimit *fëmija në qendër*.

2.Shërbimet ofrohen sipas konceptit të shërbimeve multidisplnore dhe ndër- sektoriale ku ndërliidhen shërbimet e brendshme me shërbimet që ofrohen jashtë Shtëpisë.

3.Për realizimin e shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, Shtëpitë kanë së paku këto dhoma:

3.1. dhomën miqësore të intervistimit;

3.2. dhoma e observimit;

3.3. dhomën e terapive psiko-sociale dhe këshillimit;

3.4. dhomën mjekësore dhe ndërliidhëse me sistemin shëndetësor.

4.Në rastet kur Shtëpia nuk mund të ofrojë një shërbim të caktuar e shërbimi i tillë vlerësohet i nevojshëm për fëmijën, stafi i Shtëpisë duhet të angazhohet për gjetjen e mundësive për ofrimin e një shërbimi të tillë edhe jashtë Shtëpisë, gjithnjë duke u bazuar në interesin më të mirë të fëmijës si dhe duke garantuar sigurinë e tij gjatë tërë kohës sa fëmija qëndron jashtë Shtëpisë.

Neni 8 **Standardet minimale**

1.Ministria përcakton standardet minimale funksionale dhe strukturore për Shtëpitë siç janë, por pa u kufizuar:

1.1. burimet njerëzore;

1.2.hapësirat e pranimit dhe qëndrimit;

1.3.kapacitetet e vendosjes duke llogaritur numrin e fëmijëve;

1.4.përshtatjen dhe dizajnimin e hapësirave të shtëpisë sipas konceptit miqësor;

1.5. hapësirat e përbashkëta, si kuzhina e tualetet.

1.6. ushqimin;

1.7. higjienën;

1.8.gjërat personale;

1.9. kujdesin shëndetësor fizik dhe mendor;

1.10. dhomat e intervistimit;

1.11. dhoma e observimit;

1.12. dhomat e aktiviteteve dhe shërbimeve përkatëse;

1.13. orarin e punës dhe programin ditor, rregullat e ndërveprimit ndërmjet stafit dhe fëmijës;

1.14. llojin e shërbimeve;

1.15. shpeshësinë e ofrimit të shërbimeve.

2. Procedurat standarde të veprimit ku përcaktohen parimet dhe qasja multidisiplinare, janë por pa u kufizuar:

2.1. identifikimi;

2.2. raportimi;

2.3. referimi;

2.4. mbrojtja;

2.5. tranzicioni dhe faza e largimit;

2.6. largimi nga shtëpia dhe re integrimi;

2.7. ndihma pas largimit dhe rehabilitimi.

KAPITULLI IV VENDOSJA NË SHTËPI E FËMIJËS

Neni 9

Kategoritë e fëmijës dhe kriteri përjashtues

1. Shtëpitë ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tri (3) ditë deri në gjetjen e një zgjidhje në interesin më të mirë të fëmijës, rikthim në familje ose përmes formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, kur Organi i Kujdestarisë ka arsye të bazuar:

1.1. se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës dhe fëmija ka nevojë për në një vend të sigurt dhe përkujdesje;

1.2. kur mëson për rrezikun ekzistues për fëmijën për shkak të abuzimit, keqtrajtimit, neglizhencës ose për çfarëdo rreziku që i kanoset fëmijës, për të cilin duhet urgjentisht të ndërmerren masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës;

1.3. se fëmijës për shkak të rrethanave apo nevojave të veçanta i nevojitet mbrojtje emergjente, pa përjashtuar asnjë kategori të fëmijëve në nevojë për shërbime dhe mbrojtje.

2.Shtëpitë shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet kur fëmija:

2.1. është viktimë apo dëshmitarë i të gjitha formave të dhunës;

2.2. është viktimë e veprave penale kundër integritetit seksual;

2.3. nuk mund të kthehet në shtëpi;

2.4. nuk mund të strehohet në strehim familjar;

2.5. është në shtëpi por kërkohet largimi i tyre për shkak të rrezikut të lartë që i kanoset jetës apo shëndetit të tyre.

3.Në parim vëllezërit dhe motrat nuk ndahen gjatë vendosjes, përderisa nuk vlerësohet në mënyrë të qartë që ekziston rreziku i lartë i çfarëdo forme të dhunës apo ndonjë justifikim tjetër që e arsyeton ndarjen në interesin e tyre.

4. Në rast të ndarjes së tyre, në çdo kohë dhe moment duhet bërë përpjekje që ata të bashkohen, të kenë kontakte të rregullta ndërmjet tyre, përderisa kjo nuk është kundër dëshirave dhe vullnetit të këtyre të fundit.

5.Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, brenda në Shtëpi së bashku me fëmijën duhet të qëndrojë edhe nëna nëse:

5.1.fëmija është në periudhë të ushqyerjes me gji;

5.2.fëmija i moshës së vogël është viktimë e së njëjtës vepër penale të shkaktuar edhe ndaj nënës;

5.3.për shkak të moshës , qëndrimi vetëm dhe ndarja me nënën mund të ndikojë dhe shkaktojë traumë të mëtutjeshme.

Neni 10 **Kapacitetet e vendosjes**

1. Në Shtëpi brenda afatit prej tre (3) ditësh më së shumti mund të vendosen dhjetë (10) fëmijë.

2. Përjashtimisht rasteve të emergjencës dhe situatave të jashtëzakonshme, Shtëpitë mund të rrisin kapacitetet e vendosjes. Rritja e kapaciteteve nuk duhet të kalojë gjysmën e kapaciteteve të plota të Shtëpisë dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ndikojë në dëmtimin apo zbehjen e ofrimit të shërbimeve dhe planeve të trajtimit të fëmijës.

3.Përjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, kur kapacitetet e Shtëpisë përkatëse janë të plotësuara, fëmija mund të vendoset në një Shtëpi tjetër më të afërt nga ajo e vendbanimit të fëmijës.

Neni 11

Raportimi dhe referimi i rastit

1. Çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që ndaj fëmijës është ushtruar çdo formë e dhunës është i obliguar që të raportoj rastin në Polici ose Qendrën për Punë Sociale.
2. Policia dhe Qendra për Punë Sociale pa vonesë ndërmarrin veprimet e nevojshme për vendosjen e fëmijës në Shtëpi.

Neni 12

Veprimet para vendosjes

1. Pas pranimit të informatës dhe referimit të rastit nga Policia në Qendër për Punë Sociale bëhet evidentimi i rastit dhe vlerësimi i kritereve për vendosje.
2. Përvijashimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, evidentimi dhe vlerësimi i rastit mund të bëhet drejtpërdrejtë nga Qendra për Punë Sociale në rastet kur raportimi bëhet nga burimet tjera apo identifikimi nga vet Qendra për Punë Sociale.
3. Qendra për Punë Sociale gjatë evidentimit të rastit duhet të sigurojë dëshmi dhe të regjistrojë këto dhëna:
 - 3.1. burimin e referimit;
 - 3.2. emrin dhe mbiemrin e fëmijës;
 - 3.3. datëlindjen e fëmijës;
 - 3.4. vendin e ndodhjes së fëmijës;
 - 3.5. emrin dhe mbiemrin e prindërve dhe vend ndodhja e tyre (nëse dihet);
 - 3.6. rrethanat aktuale për fëmijën;
 - 3.7. raportin social (anamneza).
4. Në rastet kur Qendra për Punë Sociale konstaton se janë plotësuar kushtet për vendosjen e fëmijës në Shtëpi, e njofton Koordinatorin e Shtëpisë dhe në koordinim ndërmarrin hapat për vendosjen e fëmijës.
5. Para vendosjes dhe gjatë gjithë kohës së qëndrimit të fëmijës në shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës, menaxheri i rastit i caktuar nga Qendra për Punë Sociale dhe kujdestari ligjor së bashku me stafin e Shtëpisë kujdesen që fëmija të përgatitet dhe të mbështetet që fëmija vendosjen e përkohshëm në Shtëpi ta pranojë me lehtësi dhe që është në interesin e tij.

Neni 13

Koordinimi dhe njoftimi

1. Qendra për Punë Sociale është përgjegjëse të koordinoj të gjitha veprimet me institucionet dhe profesionistët e përfshirë në rast deri në vendosjen e fëmijës në Shtëpi.
2. Qendra për Punë Sociale është e obliguar në mënyrë të veçantë të mbaj të njoftuar dhe njëkohësisht të marr udhëzime nga Policia, Prokuroria apo Gjykata për rastet e fëmijës që mund të jetë viktimë apo dëshmitar i dhunës me theks tek veprat penale kundër integritetit seksual.
3. Pas konstatimit të plotësimit të kushteve dhe vendimit për vendosje të fëmijës në Shtëpi, Qendra për Punë Sociale e informon Koordinatorin e Shtëpisë menjëherë për vendimin për vendosjen e fëmijës, në mënyrë që të përgatitet mjedisi për pranimin më të mirë të mundshëm për fëmijën.

Neni 14

Transporti

1. Transporti i fëmijës për në Shtëpi bëhet nga Qendra për Punë Sociale në shoqërim të menaxherit të rastit, prindit ose të kujdestarit.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni , në rastet me rrezikshmëri të lartë gjatë transportit duhet të jetë prezent edhe zyrtari policor.
3. Mjeti i transportit dhe stafi përcjellës duhet të jetë civil dhe i pa uniformë.
4. Gjatë transportimit të fëmijës respektohet dhe garantohet dinjiteti i fëmijës, në mënyrë miqësore duke shmangur stigmatizimin apo ndonjë traumë të caktuar.
5. Gjatë transportimit të fëmijës duhet të ketë përherë ushqim dhe materiale higjienike.

Neni 15

Pranimi në Shtëpi

1. Në momentin e vendosjes së fëmijës në Shtëpi, krijohet dosja personale e fëmijës, e cila përmban informatat relevante gjatë qëndrimit të fëmijës në Shtëpi.
2. Në ditën e pranimi të fëmijës në Shtëpi, koordinatori së bashku me menaxherin e rastit hartojnë një plan për adresimin e nevojave emergjente gjatë kujdesit të përkohshëm, përfshirë edhe kohën e qëndrimit në Shtëpi dhe nevojën e ndërlidhjes me profesionistë tjerë.
3. Në hartimin e planit, fëmijës i jepen mundësi të shpreh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e veta.

4. Fëmija informohet lidhur me vlerësimet dhe veprimet për interesin më të mirë të tij, bazuar në moshën dhe aftësitë e fëmijës.

Neni 16 **Vlerësimi i nevojave emergjente**

1. Vlerësimi i nevojave për shërbime emergjente mjekësore dhe të trajtimit profesional të fëmijës bëhet në momentin e pranimit të fëmijës në Shtëpi.

2. Ekzaminimet mjekësore dhe trajtimi kryhen nga personeli i specializuar i cili është trajnuar për njohjen e treguesve të abuzimit fizik, seksual dhe emocional, si dhe neglizhencës së fëmijës.

3. Ekzaminimet mjekësore dhe trajtimi kryhen në mënyrë rutinore në ambientet e Shtëpisë, përveç rasteve urgjente ose të komplikuar që kërkojnë intervenime ose pajisje të posaçme në një ambient spitalor.

4. Nëse identifikohet se fëmija ka nevojë për kujdes të specializuar mjekësor, fëmija do të shoqërohet në shërbimet e specializuara mjekësore, dhe ndihma mjekësore do ti ofrohet menjëherë.

5. Në rastet si në paragrafi 4 të këtij neni, Qendra për Punës Sociale njoftohet menjëherë për nevojën për shërbime të specializuara mjekësore.

6. Nëse, me rastin e vlerësimit të nevojave të fëmijës, bëhet e qartë se fëmija ka nevojë për mbështetje nga shërbimet sociale, çështja referohet për t'u përcjellë nga shërbimet e Qendra për Punës Sociale.

7. Në rastet kur duhet të intervistohet fëmija, kjo bëhet vetëm me urdhër të prokurorit apo gjyqtarit.

8. Intervista me fëmijën zhvillohet në dhomën miqësore për intervistim brenda Shtëpisë.

9. Ekipa profesionale multidisciplinare dëgjon dëshminë e fëmijës nga dhoma e observimit.

10. Intervista me fëmijën kryhet nga profesionistët sipas protokolleve të specifikuar dhe është e përshtatur me karakteristikat specifike të statusit të fëmijës.

11. Intervista me fëmijën zhvillohet vetëm një herë dhe regjistrohet.

12. Sipas kërkesës së Gjykatës apo Prokurorisë pas ekzaminimit mjeko ligjor dhe klinik hartohet një raport, i cili dorëzohet në Gjykatë për t'u përdorur si dëshmi.

Neni 17 **Shërbimet bazike dhe emergjente**

1. Pas pranimit të fëmijës dhe vlerësimit të nevojave emergjente, Shtëpitë sigurojnë plotësimin e nevojave.

2. Shërbimet e ofruara për fëmijën në Shtëpi përfshijnë:

2.1. Shërbimet bazike emergjente të mbrojtjes:

2.1.1. strehimin;

2.1.2. ushqimin;

2.1.3. higjienën;

2.1.4. veshmbathjet.

2.2. Shërbimet për mirëqenien e fëmijës:

2.2.1. shërbimet mjekësore;

2.2.2. shërbimet psikologjike dhe terapeutike;

2.2.3. shërbimet në trajtimin e traumës;

2.2.4. aktivitete psiko-sociale;

2.2.5. aktivitete fizike dhe rekreative;

2.3. Shërbimet e integruara:

2.3.1. shërbimet ligjore;

2.3.2. ndihmën juridike falas;

Neni 18 **Tranzicioni dhe largimi nga Shtëpia**

1. Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me stafin e Shtëpisë dhe institucionet tjera të përfshira ndërmarrin të gjitha veprimet që fëmijës brenda afatit prej tre (3) ditësh t'i sigurohet një zgjidhje dhe mbrojtje e përkohshme apo e përhershme, në mënyrë që fëmija të largohet nga ambientet e Shtëpisë.

2. Mbrojtja e përkohshme apo e përhershme përfshinë por nuk kufizohet në:

2.1. kthimin në ambientin familjar nëse janë eliminuar rrethanat apo shkaqet të cilat e kanë shkaktuar largimin e fëmijës nga familja;

2.2. vendosjen e fëmijës në ndonjërin prej formave të kujdesit alternativ, me përparësi strehimin familjar;

3. Kalimi i fëmijës nga Shtëpia në ndonjë alternativë tjetër të përkujdesjes bazohet në planin e individualizuar të hartuar nga menaxheri i rastit dhe profesionistët e ndërlidhur me rastin.

4.Shtëpia, raportin me rekomandime dhe kopjen e dosjes së rastit për fëmijën ia dorëzon menaxherit të rastit të Qendrës për Punë Sociale përkatëse.

Neni 19 **Ndihma juridike falas**

1. Fëmijës në çdo veprim dhe vendim duhet t'i ofrohet ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Fëmijës i ofrohet ndihma juridike falas në të gjitha fazat deri në sigurimin e mbrojtjes afatgjate dhe të përhershme.

Neni 20 **Personeli i Shtëpive**

1.Shtëpitë, me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore kanë personelin e nevojshëm si:

- 1.1. Udhëheqësin e Shtëpisë;
- 1.2. Psikologun;
- 1.3. Punëtorin social;
- 1.4.Kujdestarët-përkujdesësit për nevoja bazike dhe shëndetësore të fëmijës gjatë 24 orëve;
- 1.5. Zyrtarin administrativ dhe teknik.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të Shtëpive përcaktohen nga Ministria dhe janë pjesë e aktit për standardet minimale.

Neni 21 **Infrastruktura**

1.Të gjitha Shtëpitë duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas një standardi unik të aprovuar paraprakisht nga Ministria.

2. Modeli i Shtëpive duhet të dizajnohet sipas këtyre parametrave:

- 2.1. të jetë miqësor dhe i përshtatshëm për fëmijën;
- 2.2. objekti ka dy hyrje të ndara dhe të veçanta;
- 2.3. të jetë i qasshëm duke siguruar që të gjithë fëmijët kanë mundësi të lëvizin dhe shfrytëzojnë në tërësi hapësirat e Shtëpisë;

- 2.4. hapësirë ndriçuese dhe të mjaftueshme;
 - 2.5. të jetë në përputhshmëri me llojet e shërbimeve që do të ofrohen;
 - 2.6. të ofrojë siguri për fëmijën gjatë qëndrimit në Shtëpi.
3. Enterieri së bashku me pajisjet dhe sendet përcjellëse për aktivitetet që do të zhvillohen në kuadër të Shtëpisë duhet të jenë në përputhje me shërbimet që do të ofrohen dhe grup moshat e fëmijëve që do të shfrytëzojnë këto shërbime.

Neni 22 **Bashkëpunimi**

1. Për zbatimin e misionit dhe konceptit të punës, Shtëpitë nëpërmes Qendrës për Punë Sociale bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet me institucionet dhe subjektet tjera për mbrojtjen e fëmijës, si:

- 1.1. Ministrinë në pajtim me vlerësimin e nevojave të rastit;
- 1.2. Komunat;
- 1.3. Policinë e Kosovës;
- 1.4. Prokurorinë;
- 1.5. Gjykatat;
- 1.6. Institutin e Mjekësinë Ligjore;
- 1.7. Shërbimet Mjekësore (primare, sekondare dhe terciare);
- 1.8. Zyrën për Mbrojtje të Viktimave;
- 1.9. Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas;
- 1.10. Avokatin e Popullit;
- 1.11. Strehimoret;
- 1.12. Tryezën për ndihmë në menaxhimin e rastit;
- 1.13. Ekipin për të drejtat e fëmijës.
- 1.14. Organizatat e Shoqërisë Civile të licencuara;
- 1.15. Ekspertë dhe profesionistë të fushës të licencuar;
- 1.16. Kompani private të licencuara.

2. Ministria mund të lidhë memorandume të bashkëpunimit me institucionet relevante për zbatimin e konceptit të Shtëpisë me qëllim të mbrojtjes së fëmijës.

KAPITULLI V MBROJTJA E FËMIJËS

Neni 23 Politika e mbrojtjes së fëmijës

1. Ministria përgatitë dokumente përkatëse të politikave për mbrojtjen e fëmijës brenda Shtëpisë.

2. Qëllimi i dokumenteve të politikave për mbrojtjen e fëmijës është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijës dhe interesit më të mirë të tyre.

3. Ministria gjatë zhvillimit të dokumentit të politikës për ruajtjen dhe mbrojtjen e fëmijës duhet të marrin parasysh:

3.1. vlerësimin e rrezikut;

3.2. vetëdijësimin e të përfshirëve;

3.3. parandalimin e dëmit dhe shmangien e riviktimizimit;

3.4. raportimin;

3.5. reagimin dhe përgjigjen.

Neni 24 Fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Komunikimi verbal, i shkruar ose elektronik lidhur me ofrimin e shërbimit të mbrojtjes së fëmijës në Shtëpi trajtohet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Informacioni nga paragrafi 1 i këtij neni ndahet me të tjerët vetëm aq sa është e nevojshme për të ofruar shërbimin në interesin më të mirë të fëmijës.

3. Departamenti përkatës i Ministrisë mban, ruan, shfrytëzon, krijon kushte të sigurta dhe mbikëqyrë bazën e të dhënave për të gjitha Shtëpitë.

4. Regjistrimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të fëmijës bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Kodin Penal.

5. Udhëheqësi i Shtëpisë me autorizim të Departamentit ka qasje në bazën e të dhënave.

6. Udhëheqësi i Shtëpisë me pëlqim të Departamentit, mund të autorizoj njërin prej punëtorëve social të Shtëpisë për përditësimin e të dhënave në bazën së të dhënave.

7. Të gjithë të punësuarit do të informohen për detyrimet dhe përgjegjësitë dhe do të nënshkruajnë deklaratat për ruajtjen e fshehtësisë së informacioneve të mësuara gjatë punës në shtëpi me qëllim të ruajtjes së integritetit të fëmijës dhe palëve të përfshira në procedurat dhe veprimet për mbrojtjen e tij.

Neni 25

Ngritja e kapaciteteve

1. Institucionet përkatëse zhvillojnë dhe ofrojnë programe trajnuese për profesionistët për zbatimin e mbrojtjes së fëmijës në Shtëpi.

2. Trajnimet e vazhdueshme janë të detyrueshme për të gjithë stafin e Shtëpisë dhe profesionistët tjerë të cilët drejtpërdrejtë apo në mënyra tjera janë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për fëmijën.

Neni 26

E drejta e ankesës

1. Kundër vendimit të Qendrës për Punë Sociale për vendosjen e fëmijës në shtëpi, pala ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa në Departamentin në Ministri.

2. Në procedurën e realizimit për të drejtat nga shërbimet sipas kësaj rregulloreje zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KAPITULLI VI

MBIKËQYRJA

Neni 27

Mbikëqyrja

1. Departamenti përkatës në Ministri mbikëqyrë dhe monitoron Shtëpitë në lidhje me zbatimin e procedurave ligjore dhe standardeve për ofrimin e shërbimeve mbrojtëse.

2. Për çdo mbikëqyrje nga paragrafi 1 i këtij neni, mbahet procesverbal me rastin e vizitës dhe përpilohet një raport, i cili paraqet arritjet dhe mangësitë në kuadër të ofrimit të shërbimeve.

3. Departamenti në kuadër të realizimit të mandatit për mbikëqyrje dhe monitorim mund të jap këshilla, rekomandime dhe udhëzime sipas nevojës.

Neni 28

Inspektimi

1. Inspektimin e ofrimit të shërbimeve e bëjnë inspektorët përgjegjës nga Njësia përkatëse në Ministrinë sipas autorizimit.

2. Nëse gjatë inspektimit dyshohet apo ka dëshmi për dhunë, abuzim, disiplinim apo çfarëdo keqpërdorimi të interesave të fëmijës, inspektori në kuadër të obligimeve ligjore duhet të ndërmarra masa urgjente fillimisht për të urdhëruar mbrojtjen e interesit të fëmijës dhe pastaj për të ndërmarra masa për hetimin dhe raportimin e rastit tek organet kompetente.

Neni 29 Raportimi

Udhëheqësi i Shtëpisë harton raporte të rregullta çdo tre (3) muaj dhe raporte sipas kërkesës nga Ministria.

Neni 30 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

08 mars 2024